

**DAYRELL OAKLEY HILL: “NJË ANGLEZ NË SHQIPËRI –  
KUJTIME TË NJË OFICERI BRITANIK (1929-1955)”,  
Shtëpia botuese “Globus R”, Tiranë, 2006, 323 f.**

Rrallë i takon njeriut të lexojë libra të tillë, me një njohje të saktë për Shqipërinë dhe shqiptarët, për cilësinë dhe karakterin e fortë të tyre. Autori i këtij libri, Darell Okli-Hilli, i përfshirë në çështjen shqiptare për 50 vjet me radhë, mund të konsiderohet një autoritet për njohjen e Shqipërisë dhe të shqiptarëve.

Okli Hill ishte një nga ata anglezë që u thirr nga gjenerali Sir Xhoselin Persi, inspektor i përgjithshëm i xhandarmërisë shqiptare, në kohën e mbretit Zog, për organizimin dhe funksionimin e kësaj arme të shtetit shqiptar. Me rolin dhe ndihmesën e tij në organizimin e qarkkomandave, të rrethkomandave apo të postave të xhandarmërisë, kontribuoi me zellin e përkushtimit të tij, që Shqipëria të ishte një vend relativisht i qetë në atë kohë. Nëpërmjet kujtimeve të O. Hillit, na jepet me dashamirësi një informacion i saktë dhe i natyrshëm për Shqipërinë dhe shqiptarët, saqë, siç shprehet Dejvid Smajli në hyrjen e librit, “Okli Hilli ra në dashuri me Shqipërinë” (f.7).

Në udhëtimet me këmbë dhe me kalë, pothuajse në çdo pëllëmbë të truallit të shtetit shqiptar, atij i lanë mbresa të veçanta “standartet normale të mikpritjes shqiptare”. Sipas O. Hillit “kjo mikpritje ishte absolutisht e çiltër dhe pjesë e mënyrës së jetesës së popullit”.

Kudo që shkoi ai e vuri re se “Shqiptarët janë një popull shumë miqësor”. Duke e ndeshur kudo këtë dukuri të përgjithshme të shqiptarëve, ai “u detyrua” ta respektonte traditën shqiptare, sipas motos: “kur je në malësi, bëj siç bëjnë malësorët”, qoftë edhe për të ngrënë mishin me duar, pa përdorur pirunin, ose për të mos folur gjatë “kur je duke brejtur copa të forta mish dashi”. Ky zakon i shqiptarëve, për të mos folur kur hahet, për O. Hillin ishte mjaft logjik.

Gjatë udhëtimeve në “Malet e Ilirisë”, siç i quan ai trevat shqiptare me syrin e një vëzhguesi të kujdesshëm, ai konstatoi fenomenin e gjakmarrjes, si pjesë integrale e kodit të lashtë për shqiptarët. Por, ndryshe nga udhëtarë të tjerë të huaj, ai e shpreh gjakmarrjen të konceptuar nga shqiptarët, për të ndaluar vrasjen apo veprimet e

pandershme. Mbresa shumë të veçanta i la O. Hillit, qyteti i Elbasanit, ku ai jetoi, i cili ishte “një vend paqësor dhe i bukur”.

Ngjarjet historike të shqiptarëve përcillen me respekt nga Okli Hilli. Në mënyrë të veçantë ai vlerëson Kongresin e Lushnjës, i cili “pohoi pavarësinë e vendit”. Misionin e tij në Shqipëri nuk e shikonte ngushtë me rolin e organizatorit të armës së xhandarmërisë, por më gjerë. Ai na shfaqet me një vizion modern për zhvillimin e Shqipërisë. Në këtë kuadër, ai kujtonte vitet 1930-1931, kur ishte arbitër i ndeshjeve të futbollit shqiptar si një kohë të mbushur plot me ngjarje të denja për një vend modern. Ai ishte i pari që solli, botoi dhe përhapi, rregullat e futbollit në Shqipëri, si një nga organizatorët kryesorë të themelimit të kampionateve të futbollit dhe të krejt sporteve.

Okli Hill ka hyrë në historinë e vlerësimit të traditës sonë sportive, me përcaktimet dhe vlerësimet e bëra për futbollin dhe futbollistët tanë. “Futbollistët shqiptarë, - kujtonte ai, - kishin një ide fare të mirë për lojën, demonstroi një futboll energjik dhe të pastër”.

Një kapitull të veçantë të kujtimeve për Shqipërinë, O. Hill ia kushton bëmave dhe konsideratave të tij për kohën kur në Shqipëri qeveriste mbreti Zog. Ndaj dhe këtë kapitull e titullon “Shqipëria e Mbretit Zog”. Në udhëtimet e shërbimit në Veri dhe në Jug të Shqipërisë, ai ka rastin të përshkruajë me hollësi jetën në këto treva, zakonet, ndërtimet, natyrën, njerëzit të cilët e rrethojnë. Ai bën përcaktime e vlerësime për Muharrem Bajraktarin, Ded Gjakovën, Jahja Çaçin, Gjon Rakacollin, Kamber Qafmollën, Dervish Dumën dhe Ahmet Zogun. Duke vlerësuar A. Zogun, ai pranon faktin se ai i luajti mirë kartat e tij, saqë Musolini, më në fund, e humbi durimin dhe përdori grushtin e rëndë” (f.87). O. Hilli kishte një intuitë të hollë për ngjarjet që pritej të ndodhnin në jetën politike të Shqipërisë. Kur misionit të gjeneral Persit i bëhej e njohur ndërprerja e kontratës, në prill të vitit 1938, Hilli do të kuptonte se “është padyshim presioni i Musolinit që kontrata jonë të mos ripërtërihej edhe për dy vjet të tjera... Me sa duket, - shkruan autori i librit, - okupimi i Shqipërisë më 1939 tashmë ishte i planifikuar” (f.123). Dhe kjo situatë ishte parashikuar me saktësi, sepse këtë e vërtetojnë dhe dokumentet: që vendimi për pushtimin e Shqipërisë ishte marrë pas kthimit të G. Çianos nga dasma e Ahmet Zogut, në prill 1938.

Në udhëtimet e bëra përpiqej të gjente tiparet e përbashkëta, por edhe të veçantat e krahinave të Shqipërisë. Ndonëse ai deklaroi prerë se Jug i Shqipërisë është shumë i ndryshëm nga Veriu i saj, e ka të vështirë

ta shpjegojë këtë fakt. Megjithatë ai pohon qartësisht dhe me bindje se “me gjithë dallimet, shqiptarët janë një popull i vetëm... ata flasin shqip, në themel ata mendojnë njëllëj” (f.117). Dhe më tej shprehet se “anë e mbanë vendit i huaji ndeshet me të njëjtën dashamirësi dhe me të njëjtën buzëqeshje, si në Veri ashtu dhe në Jug”. Në shtëpitë e fshatit Dardhë të Korçës ai konstatonte se “stili ishte krahasimisht modern, të ngjashme me shtëpitë fshatare moderne angleze” (f.110). Mbresat që përjetoi në Shqipëri, kudo që shkoi, e entuziazmuan O. Hillin, për t’u shprehur se, “Shqipëria më dha mua ndjenjën e rinisë së përjetshme” (f.127).

Pas një periudhe 10-vjeçare në Shqipëri, ai përjetoi dhe preku shumë ndryshime të saj gjatë mbretërimit të A. Zogut. Por mbi të gjitha, ai i referohej ndërgjegjësimit kombëtar të shqiptarëve gjatë viteve 1928-1938. “Ishte kjo ndjenjë e përtërirë krenarie kombëtare, - konkludonte O. Hill, - mbi të cilën u ndërtua fryma e rezistencës dhe u rrit gjatë luftës, ajo që shkaktoi dhimbje koke, fillimisht divizioneve fashiste dhe më vonë atyre gjermane”.

Ky konstatim i nivelit të një studiuesi të mirëfilltë shërben si argument i fortë për të zhvlerësuar vendin që i ka dhënë historiografia komuniste, rolit të Partisë Komuniste për motivimin e shqiptarëve në Luftën II Botërore. O. Hill nuk heziton që të vejë në dukje faktin se ndjenja e krenarisë kombëtare që i motivoi shqiptarët të ngriheshin në luftë, u shfrytëzua nga udhëheqësit komunistë për të gënjyer shqiptarët e thjeshtë që të besojnë se lëvizja komuniste ishte një lëvizje nacionalçlirimtare e vërtetë. Duke qenë mjaft objektiv, autori pohon me plot gojën se “Ky mashtrim, fatkeqësisht, arriti deri në Londër, që i mbështeti ata (komunistët – M.D.) me ndihma në vend që t’ua jepte paratë atdhetarëve të vërtetë, si: Abaz Kupi dhe Mithat Frashëri” (f.127).

O. Hilli nuk iu nda Shqipërisë edhe pas pushtimit të saj nga Italia. Duke qenë pranë SOE, në Beograd, ai ishte frymëzues e organizator për përgatitjen e një kryengritjeje shqiptare në Shqipërinë e Veriut në vitin 1941. Edhe pse në situatë lufte, duke bashkëpunuar me figura të njohura nacionaliste të Shqipërisë së Veriut, ai “harrohet” pas natyrës së bukur dhe të ashpër të malësisë veriore të Shqipërisë. Bashkëpunimin me jugosllavët për realizimin e kësaj ndërmarrjeje luftarake kundër italianëve në Shqipërinë e Veriut, O. Hilli e vlerëson si një gabim fatal. Kjo sepse e komprometonte organizimin e kryengritjes kundër italianëve, pasi nacionalistët që bashkëpunuan me jugosllavët u konsideruan nga popullsia shqiptare si vegla të jugosllavëve (f.149).

Atij iu desh të kalonte shumë peripeci, për t' u kthyer në Britaninë e Madhe, duke i shpëtuar edhe kampit gjerman.

Lidhjen me Shqipërinë O. Hill nuk e ndërpreu as pas luftës. Ai u angazhua në UNRRA (Administrata e Kombeve të Bashkuara për Ndihmë e Rehabilitim) me detyrën e zëvendëskryetarit për furnizim e transport të Misionit.

Me shumë interes janë parashtrimet për një sërë ndodhish e pengimesh që krijonte E. Hoxha dhe qeveria shqiptare për kryerjen e misionit të UNRRA-s. Mbi të gjitha ai përshkruan bisedat e vështira me E. Hoxhën, për dyshimet që kishte ai për rolin e anglo-amerikanëve në Shqipëri në fund të luftës dhe për rrjedhojë dhe për UNRRA-n. Me shumë vërtetësi dhe në mënyrë bindëse O. Hill ka bërë “skanerin” e mentalitetit të udhëheqësve komunistë, ku në mendjet e tyre kishte zënë rrënjë dyshimi ose urrejtja. “Ata (komunistët - M.D.) nuk i besonin askujt që nuk bënte pjesë në filozofinë politike të tyre, e cila nuk përmbante asgjë tjetër përpos motiveve të këqia” (f.211).

O. Hilli shpreh keqardhjen për këtë qëndrim të komunistëve, duke përgënjeshtuar “faktet” që jepen në libra propogandistikë të tipit “Dështimi i kompleteve”, ku dilte në mënyrë të qartë mosmirënjohja për ndihmat e marra nga UNRRA.

Interesimi për Shqipërinë dhe për shqiptarët nuk u shua asnjëherë tek O. Hilli. Në vitet 50-të kur ishte me punë në ambasadën angleze në Athinë, ai do të ndeshte në Atikë paraardhësit e shqiptarëve që kishin qenë aty prej shumë shekujsh. Shumë nga njerëzit, që ai takoi, flisnin shqip në shtëpi. “Dikur thuhej se shumica e burrave të ushtrisë greke, deri në Luftën e Parë Botërore fliste shqip, pra ishin me origjinë shqiptare” (f.225).

Këtë dukuri ai do ta ndeshte shumë më qartë në Janinë, për të cilën ai shprehet se “vetë qyteti mund të ishte fare bukur edhe një Elbasan apo një Tiranë e vjetër” (f.228), duke theksuar kështu tiparet e përbashkëta kulturore e arkitekturore shqiptare. Nga të gjitha konstatimet e tij në Janinë arrinte në përfundimin se “shumë nga popullata e Janinës dhe e rrethinave janë me origjinë shqiptare”. Si një autor objektiv, ai nuk lë pa përmendur faktin që e kishte të freskët nga vitet e luftës, ndjekjen dhe përzënien nga Greqia të 20 000 çamëve nga forcat e djathta greke. Në afërsi të “Tre Urave”, në kufi afër Përmetit, me vështrimin nga Shqipëria, O. Hilli derdhi një pikë lot nostalgjje, duke mos pasur mundësi për të ardhur në Shqipëri.

Mallin për Shqipërinë dhe për shqiptarët, O. Hilli e shfaqti në takimet që bëri me disa nga refugjatët shqiptarë në kampin e Lavrionit (Greqi), të cilët pohonin të njëjtën histori dhe nga të cilët kuptohej se, “askush nuk e donte komunizmin”. Dëshira universale e njerëzore për të ikur nga komunizmi dhe fakti se ata nuk kanë mundësi për t’u larguar legalisht, i ka shërbyer O. Hillit për ta konsideruar këtë “një argument të pakundërshtueshëm (të pozicionimit të shqiptarëve – M.D.) kundër komunizmit” (f.233).

Libri mbyllet me disa shkrime të O. Hillit në organet e shtypit anglez si dhe disa letra gjatë korrespondencës së tij me figura të njohura politike angleze dhe shqiptare. Në qendër të tyre ishte fati i Shqipërisë dhe i çështjes shqiptare. Ai iu bënte apel shqiptarëve për t’u orientuar drejt në rrethanat e luftës. Ai shfaqti hapur simpatinë e tij për Shqipërinë e viteve të qeverisjes së Ahmet Zogut, duke dalë kundër qeverisë së Hoxhës që “sapo i kishin dalë puplat” (f.278). O. Hilli shpreh keqardhjen e tij se “në pranverën e vitit 1944, Ministria e Jashtme angleze kishte dalë kundër këshillës së tij, për të mos mbështetur vetëm rezistencën e lëvizjes partizane, duke ditur se ajo ishte nën ndikimin komunist. Në letrën drejtuar ministrit të Jashtëm anglez ai shprehet qartë që “Unë nuk dua ta besoj që ju mund të mbështesni rivendikimet greke ndaj Shqipërisë së Jugut” (f.280).

Gjykimet dhe vlerësimet objektive për qëndrimet politike, për rolin e figurave historike, për qëndrimet e aleatëve ndaj qëndresës shqiptare gjatë Luftës II Botërore, të cilat zënë vend në këtë libër dhe veçanërisht në shtojcën dokumentare të tij, do të përbënin një ndihmë të madhe për t’u marrë në konsideratë nga studiuesit shqiptarë apo të huaj, që merren me këtë periudhë historike.

Vlera shkencore e librit të O. Hillit rritet me ilustrimet që jepen nëpërmjet hartës dhe fotografive origjinale të autorit, të cilat paraqesin jo vetëm vendet, por dhe njerëzit e figurat shqiptare që përcollën autorin në vitet e qëndrimit në Shqipëri.

Lexuesi shqiptar i këtij libri në mënyrë të natyrshme do të ushqejë respekt për botuesin e parë në Londër, B.D. Destani (Qendra për Studimet Shqiptare), për përkthyesin Agim Basha, për redaktorin Afrim Koçi, si dhe për financuesin z. Ardian Jegeni, të cilët bënë të mundur sjelljen në shqip të këtij libri.

Në vend të pashënies përcillen vlerat e librit dhe të autorit, nëpërmjet fjalës së Besnik Dizdarit, President i Albanian Sport Press

Association (ASPA), mbajtur në Shkodër më 7 shkurt 2005, me rastin e nderimit të kolonel Darell Okli Hillit (pas vdekjes) me Çmimin Kombëtar “Luigj Shala”.

**Muharrem DEZHGIU**